



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM DRAGASH



Nr. 13/28

Datë: 20.08.2026

Dragash

Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Kosovës, në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, në Ligjin nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, në Udhëzimin Administrativ 03-2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë, dhe në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, drejtorja e Institucionit Parashkollor në Dragash shpall:

KONKURS

Për regjistrimin e fëmijëve në Çerdhen e Fëmijëve në Dragash (për vitin shkollor 2026 - 2027)

Drejtorja për Arsim në Komunën e Dragashit njofton prindërit/kujdestarët ligjorë se është hapur konkursi për pranimin e fëmijëve për grupmoshën 3 – 4, dhe 4 – 5 vjeç në Çerdhen e Fëmijëve në Dragash për vitin edukativ-arsimor 2026/2027. Ky konkurs është i hapur për të dy komunitetet dhe kanë të drejtë aplikimi të gjithë.

Kushtet e Aplikimit

Për të aplikuar për pranimin e fëmijës në çerdhe, prindi/kujdestari duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- Certifikata e lindjes së fëmijës;
- Vërtetimi i marrjes së vaksinave (libreza e vaksinimit ose vërtetimi nga Qendra e Mjekësisë Familjare);
- Kopja e letërnjoftimit të prindit/kujdestarit ligjor.

Afati dhe Mënyra e Dorëzimit

- **Afati i aplikimit:** Konkursi mbetet i hapur çdo ditë pune nga ora 9 – 12 nga data e publikimit të konkursit deri më date: 31.08.2026.
- **Vendi dhe mënyra e dorëzimit:** Dokumentet e plota duhet të dorëzohen fizikisht, në zyrat e Çerdhes së Fëmijëve në Dragash.
- **Vërejtje:** Dokumentet e paketuara apo të plotësuara pas afatit të caktuar nuk do të merren parasysh.

Drejtoresha e IEAAP

znj. Blerina Kamberi

